



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr. 3481/2 Prot

Gramsh më, 02.08.2026

VENDIM

Nr.63, Datë,28.08.2026

PËR

NDRYSHIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE, PËR BASHKINË GRAMSH, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 65 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”; VKB Nr. 105, datë 29.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor të Bashkisë Gramsh, për vitin 2026”, si dhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit;

VENDOSI:

1. Ndryshimin e shpërndarjes së fondit të kushtëzuar në shumën 9,342,128 (nëntë milionë e treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, me kod produkti 21AD502 “Rehabilitimi i objekteve të ndryshme infrastrukturore”, akorduar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, sipas objekteve dhe vlerave të mëposhtme:

- * Mbrojtje lumore në Luginën e Gribës, me vlerën 3,985,140 lekë me TVSH.
- * Ndërhyrje me tombina në përroin e Shelcanit dhe përroin e Frashërit, me vlerën 1,196,727 lekë me TVSH.
- * Rikonstruksion i urës në segmentin rrugor Dufshan-Sult, me vlerën 1,099,777 lekë me TVSH.
- * Rikonstruksion i urës në fshatin Galigat, me vlerën 1,199,854 lekë me TVSH.
- * Rikonstruksion i urës në Dumberas, me vlerën 1,199,709 lekë me TVSH.
- * Rikonstruksion i urës së këmbësorëve në fshatin Kukur, me vlerën 660,921 lekë me TVSH.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Enis ZANI

